

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.
më ____ . ____ . 2019

Tiranë,

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)

Adresa: Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 9

Kontakt: www.ost.al; e-mail: info@ost.al

Për: **BOE: - “SHANSI-INVEST” sh.p.k., me NIPT J61924002T**

Adresa: Tiranë, Farkë, Sauk, Farkë e Madhe

- “G.A.C” sh.p.k., me NIPT L61619031A

Adresa: Rruga “Him Kolli”, pallati i ri 2T, kati i parë, Tiranë

- “LALA” sh.p.k. me NIPT J76418903B

Adresa: Krumë, Kukës

- “PASTRIME SILVIO” sh.p.k., me NIPT K91413010N

Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Fatmir Haxhiu”,
Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” - me mjete elektronike – Punë

Numri i referencës i procedurës: REF-25749-06-07-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtim i linjës 220 kV me dy qarqe Komsî-Shumat”

Kohëzgjatja e kontratës: 24 (njëzet katër) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Datë 17.06.2019, Nr. 24.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Fondi Limit: 1,051,871,760 (një miliard e pesëdhjetë e një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e

një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 14.08.2018

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 3 (tre) ofertues, me vlerë përkatëse të ofruar:

1. BOE “DOKO” shpk me NIPT J62903324K
“Gjeokonsult CO” sh.p.k. me NIPT K91810005U
“Victoria Invest” sh.p.k. me NIPT K32712206U

me ofertë ekonomike 833,333,332 (tetëqind e tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy) Lekë pa TVSH.

2. OE “Euronet” shpk me NIPT K72013009U
pa ofertë ekonomike.

3. BOE “SHANSI-INVEST” shpk me NIPT J61924002T
“G.A.C” sh.p.k. me NIPT L61619031A
“LALA” sh.p.k. me NIPT J76418903B
“Pastrime Silvio” shpk me NIPT K91413010N

me ofertë ekonomike 999,978,462 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH.

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “EURONET” shpk, me NIPT K72013009U

për arsye se nuk ka paraqitur asnjë dokument në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit përfshirë këtu edhe ofertën ekonomike.

2. BOE “DOKO” shpk me NIPT J62903324K
“Gjeokonsult CO” sh.p.k. me NIPT K91810005U
“Victoria Invest” sh.p.k. me NIPT K32712206U

për arsye se:

- Marrveshja me Nr. 1437 REP Nr. 651 KOL., date 02.08.2019, nënshkruar me qëllim krijimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE) nuk është në përputhje me:

- i. piken 1 të nenit 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të VKM-se Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik, e ndryshuar”, ku ndër të tjera citojme: ... **Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi;**
- ii. piken 2 të nenit të sipercituar, i cili gjithashtu shprehet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, **përqindja e pjesëmarrjes së**

punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. ...”,

sepse ndarja e puneve nuk është bërë me elemente konkrete (që do të thotë ndarje sipas zerave të ofertes, preventivave të punimeve të paraqitura) por thjeshtë është përshkruar në mënyrë të përgjithshme dhe të paqarte, si vijon: “1- Doko shpk, do të jetë përgjegjës për pjesën më të madhe të projektit, ofrimin e materialeve paisjeve, do të kryejë punime për pjesën më të madhe të kontratës instalimin e paisjeve dhe komisionimin/testimin. 2- Victoria Invest shpk do të kryejë punime civile të tipit: hapje rruge, punime dhe mbrojtje lumore, bonifikime, shpime gjeologjiko-inxhinierike, shërbime elektronike, etj. 3- Gjeokonsult CO do të kryejë kryesisht studime gjeologjiko-inxhinierike-hidrogeologjike, shërbime për inxhinierinë e mjedisit, etj.”. Sic shikohet tek shërbimet dhe punët që do të kryejnë palet e përshkruara në marrëveshje nuk janë të ndara konkretisht sipas zerave të punimeve në oferte, duke lënë jashtë këtij përshkrimi dhe element të tjerë të rëndësishëm të kontratës. Përshkrimi i ndarjes së punimeve në mënyrë konfuze dhe jo në mënyrë konkrete e bën të pamundur edhe vlerësimin në lidhje me pikën 3 të nenit 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të VKM-së, për prokurimet, në lidhje me plotësimin e kërkesatve ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike të cilat duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, **në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.**

○ Katalogjet e shtyllave të prodhuesit SA_RA dhe katalogjet e prodhuesit “Mitas” të ofruara nga BOE Doko & Gjeokonsult CO & Victoria Invest, janë të papërkthyer në gjuhën shqipe. Kjo në kundërshtim me: i) pikën 4.6 “Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje” të njoftimit të kontratës në DST, ku është përcaktuar vetëm gjuha shqipe si gjuhë për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje dhe ii) Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, citojmë “*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe*”.

○ BOE Doko & Gjeokonsult CO & Victoria Invest, për mallrat/paisjet e kërkuara ka paraqitur nga dy prodhues për secilin, pra duke na paraqitur disa alternativa. Kjo bie në kundërshtim me:

- i. DST-te ku në “Njoftimin e kontratës” pika 2.14, AK, ka përcaktuar se nuk pranohen alternativat/variantet
- ii. Nenin 54 (Alternativa) pika 2 e LPP-së, citojmë “*Autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës duhet të përcaktojë nëse i autorizon alternativat, në të kundërt, ato nuk lejohen.*”

○ Nuk ka përmbushur pikën 2.3.3, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ku thuhet “*Operatori ekonomik ofertues ose personi fizik apo juridik që disponon licencat e projektimit i cili ka marrëveshje kontraktuale me ofertuesin për realizimin e projektit, duhet të jetë i paisur me licence profesionale për përdorimin e aplikacioneve ”PLS CADD and TOWER” ose aplikacione të ngjashme për realizimin e projektit të linjes*” **sepse** në lidhje me këtë OE Doko, pjesë e BOE ka paraqitur një marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe me prodhuesin “Mitas” i cili ky i fundit angazhohet

per realizimin e projektit, nese DOKO shpallet fitues. Mirepo Ofertuesi per disponuesin e aplikacionit PLS CADD, “Mitas” nuk ka paraqitur licensat e nevojshme te projektimit te kerkuara ne kriterin 2.3.2, tek kriteret e vecanta te ketyre DT-ve.

- Nuk ka permbushur piken 2.3.4, “Per kapacitetin teknik” te kriterave te vecanta te kualifikimit sepse: OE “DOKO” shpk, pjese e BOE-se, i cili ne baze te marrveshjes se bashkepunimit ka marre persiper te realizoje 97.8% te punimeve, i mungojne pikat e Licences si vijon: Kategoria NP-12 Punime te inxhinierise se mjedisit; Kategoria NS-20 “Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje”; si dhe disponon Kategorine NP-4 “Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale” Klasifikimi C, ku eshte kerkuar Klasifikimi D. Referuar pikes 3 te nenit 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” te VKM-se Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik, e ndryshuar” ku nder te tjera thuhet “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.6, “Per kapacitetin teknik” te kriterave te vecanta te kualifikimit sepse:
 - i. OE “DOKO” shpk, pjese e BOE-se, si drejtues teknik ka vetem 3 (tre) inxhinier dhe pikerisht 1 (nje) Inxhinier Elektrik, 1 (nje) Inxhinier Ndertimi si dhe 1 (nje) Inxhinier Topograf. Ne baze te marrveshjes se bashkepunimit “Doko” shpk ka marre persiper te realizoje 97.8% te punimeve, referuar pikes 3 te nenit 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” te VKM-se Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik, e ndryshuar” ku nder te tjera thuhet “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje” te pakten “DOKO” shpk duhet te kishte shumicen derrmuese te Inxhinierve te kerkuar.
 - ii. Asnjeri nga antaret e BOE nuk kane ne stafin e tyre te pakten 1 (nje) Inxhinier mjedisi profili energjetik.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.10, “Per kapacitetin teknik” te kriterave te vecanta te kualifikimit sepse nuk disponon Instrument per matjen e dispresionit kromatik me shtrirje dinamike min 55 db. Dokumenti (Invoice) i paraqitur ne lidhje me kete paisje te rendesishme per realizimin e testimit, instalimit dhe komisionimit te OPGW-se, ne pershkrimin e tij nuk percakton vleren e shprehur ne db, te kerkuar. Dokumenti i paraqitur eshte i paperkthyer.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.14, “Per kapacitetin teknik” te kriterave te vecanta te kualifikimit sepse nuk ka paraqitur test reporte per asnjerin nga prodhuesit e shtyllave te deklaruar, test reportet jane projektuar nga DOKO.
- Nuk ka permbushur piken 2.3.16/b, “Per kapacitetin teknik” te kriterave te vecanta te kualifikimit sepse te dhenat teknike te lokalizatorve te paraqitura

nuk janë ne përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe katalogjet e produkteve të “KEHUI” nuk janë të përthyerë. Paisjet SEL-400 dhe paisjet e prodhuesit “KEHUI” në lidhje me sistemin e lokalizimit të avarive nuk plotësojnë të dhënat bazike të kërkuara në specifikimet teknike. Pikerisht mangësitë qëndrojnë në lidhje me kapacitetin e kanaleve në hyrje dhe në dalje; me sistemin e mbledhjes së informacionit; në komunikimin e sistemit etj.

- Nuk ka përmbushur piken 2.3.16/c, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të vecanta të kualifikimit sepse asnjëri nga anëtarët e BOE-së nuk kanë në stafin e tyre specialist të certifikuar nga prodhuesi për instalimin dhe komisionimin e lokalizatorve të avarive sic kërkohej në këtë kriter kualifikimi, citojmë: “Operatori ekonomik ofertues me qëllim vendosjen në punë me sukses të këtij sistemi duhet të ketë në stafin e tij të pakten 2(dy) specialist të certifikuar nga prodhuesi për instalimin dhe komisionimin e lokalizatorve të avarive. Specialistet e mesipër duhet të figurojnë në listpagesat e operatorit ekonomik të pakten për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit”. Doko shpik ka paraqitur nga një dokument të nënshkruar nga prodhuesi “KEHUI” dhe distributori “Saturn Electric” ddo, Beograd, i prodhuesit “SEL” Inc, për të cilin nuk ka asnjë dokument që vërteton se është distributor i autorizuar i këtij të fundit, të cilët shprehen se kanë në procedurat të trajnojnë nga një specialist të DOKO-s dhe parashikojnë se do të perfundojnë trajnimin kur projekti të fillojë implementimin. Sa me sipër KVO nuk mund të gjykojë për kapacitetet e ofertuesit në të ardhmen. Kriteri është i qartë dhe kërkon që minimalisht 2 (dy) specialist të certifikuar të jenë në stafin e operatorit ekonomik të pakten tre muajt e fundit.
- Nuk ka përmbushur piken 2.3.16/d, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të vecanta të kualifikimit sepse BOE-së nuk ka dëshmuar se ka të pakten një kontratë të mëparshme të realizuar në sisteme të lokalizimit të avarive ashtu sic kërkohej në këtë kriter. Kontrata e paraqitur nën emërtimin e fajlit 52-NST_110_kV_AES-Lokalizimi_i_avarive(1).pdf, me objekt “Nërtim i N/stacionit 110/10 kV për fabrikën e ferrokromit dhe linjen 110 kV” pas verifikimit të imtesishëm të situacionit të saj, rezulton se nuk ka asnjë zë në lidhje me lokalizator avarish.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “SHANSI-INVEST” sh.p.k.**, me **NIPT J61924002T**, Adresa: Tiranë, Farkë, Sauk, Farkë e Madhe; & **“G.A.C” sh.p.k.**, me **NIPT L61619031A**, Adresa: Rruga “Him Kolli”, pallati i ri 2T, kati i parë, Tiranë; & **“LALA” sh.p.k.** me **NIPT J76418903B**, Adresa: Krumë, Kukës; & **“Pastrime Silvio” sh.p.k.**, me **NIPT K91413010N**, Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Fatmir Haxhiu”, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë; se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **999,978,462 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH**,

është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë *Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë -Durrës, Km 9*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të procedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.08.2019.

Ankesa: Jo.

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Skerdi Drenova